



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 81, datë 29.06.2020

PËR

**NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN NR. 118, DATË 19.09.2011 “MBI KARTËN E
AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË AUTORITETIN E MBIKËQYRJES FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 1, të Rregullores nr. 118, datë 19.09.2011 “Mbi kartën e auditimit të brendshëm në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si më poshtë:

“Objekti i kartës së auditimit të brendshëm

- 1. Karta e Auditimit të Brendshëm është një dokument zyrtar, i cili përcakton qëllimin, autoritetin, dhe përgjegjësitë e veprimtarisë së auditimit të brendshëm. Ky dokument përforcon pozicionin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm brenda njësisë publike, autorizon drejtuesin dhe stafin e njësisë së auditimit të kenë të drejtën dhe përdorim të pakufizuar mbi çdo dokument dhe informacion zyrtar, prona dhe personel, të cilat kanë lidhje me performancën e angazhimit, si dhe përcakton objektin e veprimtarive të auditimit të brendshëm. Komiteti i Auditimit/Bordit drejtues (në rastet kur një organ i tillë ekziston) dhe titullari i njësisë publike ka të drejtën për aprovimin përfundimtar të kartës së auditimit të brendshëm.”*

2. Ngarkohet Njësia e Auditimit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE